



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike/Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost
Kosovo Academy for Public Safety

Nr. ref: 135/2019
Datë: 14.10.2019

Në mbështetje të nenit 14 të Ligjit Nr.04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, nenit 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenin 26 të Ligjit Nr.04/L-037 mbi Arsimin e lartë në Kosovë, si dhe dispozitat e Rregulloren (QRK) – Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike:

Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Shpall

KONKURS

Për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit akademik në Fakultetin e Sigurisë Publike

- 1. Një mësimdhënës për lëndët:** Kriminologji; Penologji; Krimi dhe ndëshkimi; Viktimologji.

Personeli akademik do të angazhohet për mësimdhënie akademike, kërkime shkencore - mësimore, mësimdhënie në trajnime si dhe në zhvillimin e kurikulave.

Zgjedhja/rizgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) – Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike.

Kandidatet që paraqiten në konkurs duhet të dorëzojnë:

- Kërkesën për aplikim;
- Një CV profesionale (modeli europass);
- Ekstraktin e lindjes (jo me e vjetër së 6 muaj) dhe kopjen e letërnjoftimit;
- Certifikatën që vërteton se kandidati nuk është i dënuar për vepër penale, siç është caktuar me ligjet në fuqi;

- Kopjen e diplomës, të studimeve themelore, master/magjistraturë dhe doktoratës (të noterizuara);
- Dëshmitë për publikimet shkencore e profesionale;
- Dëshmi mbi përvojën e punës në mësimdhënie;
- Vendimin për nostrifikimin e diplomës (kandidatet që kanë mbaruar studimet jashtë vendit).
- Vendimin e zgjedhjes së fundit (kandidatet të cilët janë të punësuar në ndonjë institucion të arsimit të lartë në Kosovë);
- Si dhe informata tjera shtesë të cilat konsiderohen të rëndësishme për aplikantin.

Njohja e gjuhës angleze apo ndonjë gjuhë tjetër të huaj, është përparësi për konkuresit.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike:

- Në kopje fizike dokumentet dorëzohen në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, në Vushtrri, Ndërtesa e Administratës, Zyra e Personelit nr.01;
- Në kopje elektronike dokumentet dorëzohen të skanuara në emailin: rekrutimi.aksp@rks-gov.net ;

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** kalendarike nga dita e shpalljes në gazetë, respektivisht deri me datën **28.10.2019**.

Aplikacionet e arritura pas afatit, si dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen e internetit në këtë adresë: www.aksp-ks.net.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit, në numrin e tel: 028 590 070 Ext 210 ose 211, prej orës 08:00 - 1600.